



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:157774

Datë: 01.10.2024

Numri i dokumentit: 06238197

CN.nr.350/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, në çështjen juridike jokontestimore, sipas propozimit të propozuesit H. K. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. E.Q. nga Prizreni, ndaj kundërpropozuesve: B.K. nga Prizreni, tani me punë të përkohshme në Gj. dhe F.K. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av. S.M. nga Prizreni, për shkak të ndarjes fizike të paluajtshmërisë, jashtë seancës gjyqësore, më datë 01.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. NDËRPRITET procedura në këtë çështje juridike jokontestimore, sipas propozimit CN.nr.350/2021 e datës 16.07.2021, të propozuesit H.K. nga Prizreni, ndaj kundërpropozuesve: B.K. dhe F.K. që të dy nga Prizreni, për shkak të zgjidhjes së çështjes paraprake.

II. Procedura e ndërprerë sa i përket pikës nën I. të dispozitivit, do të vazhdohet pasi të përfundojë procedura në formë të prerë tek organi kompetent, apo kur gjykata e çështjes konstaton se nuk ekzistojnë më arsyet për të pritur përfundimin e saj.

A r s y e t i m

Propozuesi H.K. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. E.Q. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar propozim, ndaj kundërpropozuesve: B.K. nga Prizreni, tani me punë të përkohshme në Gjermani dhe F.K. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av. S.M. nga Prizreni, për shkak të ndarjes fizike të paluajtshmërisë.

Gjykata në këtë çështje juridike më datë 01.10.2024 ka caktuar seancën gjyqësore, në të cilën kanë prezantuar i autorizuari i propozuesit dhe i autorizuari i kundërpropozuesit F.K.

I autorizuari i kundërpropozuesit Florije Kryeziu ka deklaruar se me aktvendimin CN.nr. 108/21 të datës 21.11.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, është anuluar aktgjykimi i formës së prerë i Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.926/16 i datës 01.10.2019, dhe lënda është kthyer në rishqyrtim dhe vendosje pranë Gjykatës së Shkallës së parë. Sipas aktgjykimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, propozuesi në atë çështje kontestimore si paditës është shpallur si bashkëpronarë në paluajtshmërinë e cila është objekt i kësaj çështje juridike për ndarje fizike në pjesë ideale prej 1/3. Në këto rrethana vlerësoj se çështja e kthyer në rigjykim dhe rivendosje përbën çështje paraprake në këtë çështje juridike për ndarjen e paluajtshmërisë. Andaj gjykatës i propozoj që kjo çështje të ndërpritet me arsyetimin se kemi çështjen paraprake të pa zgjidhur e cila zgjidhet dhe procedohet sipas rregullave të procedurës kontestimore.

I autorizuari i propozuesit sa i përket propozimit për ndërprerjen e procedurës në këtë çështje juridike nuk e ka kundërshtuar, ngase çështja e referuar më lartë nga gjykata përbën çështje paraprake.

Së këndejmi, gjykata gjeti se procedura gjyqësore apo jashtëgjyqësore lidhur me vërtetimin e pronësisë në ngastrën kadastrale kontestuese, përbënë çështje paraprake në këtë çështje juridike jokontestimore, e cila duhet të zgjidhet në procedurë të veçantë dhe të ndarë nga kjo procedurë jokontestimore, pastaj të mund të trajtohet dhe vlerësohet çështja e ndarjes fizike të paluajtshmërisë që është objekt në këtë çështje juridike.

Kësisoj, në nenin 13 të LPK-së theksohet që “kur vendimi i gjykatës varet nga zgjidhja paraprake e çështjes se a ekziston ndonjë e drejtë subjektive apo marrëdhënie juridike, e lidhur me të ende nuk ka marrë vendim, gjykata apo organi tjetër kompetent (çështja paraprake), atëherë gjykata ka tagër që vetë ta zgjidhë çështjen e tillë, në qoftë se me dispozita të veçanta nuk është caktuar ndryshe”. Pastaj, me nenin 278 par. 1 pika a) parashihet se “përveç rasteve të parashikuara me këtë ligj, gjykata e ndërpret gjykimin po që se ka vendosur që vetë të mos e zgjidhë çështjen paraprake (neni 13 i këtij ligji)”. Ndërsa, në nenin 3 të Ligjit për procedurën jokontestimore (LPJ) përcaktohet që “në procedurën jokontestimore përshtatshëmrisht zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurën kontestimore, po qe se me këtë ligj nuk është paraparë ndryshe”.

Andaj, gjykata vlerëson se është e domosdoshme që të përfundoj procedura në formë të prerë lidhur me çështjen juridike të vërtetimit të pronësisë lidhur me paluajtshmërinë kontestuese, pastaj të vazhdohet procedura jokontestimore lidhur me ndarjen fizike të paluajtshmërisë. Kjo për faktin se gjykata vlerëson që duhet të jetë e përcaktuar në mënyrë konkrete dhe specifike e drejta e pronësisë në një ngastër kadastrale, në mënyrë që të mund të kërkohet ndarja fizike e saj

Andaj, duke marrë parasysh të lartcekurat, konform nenit 13, 278 dhe 280 të LPK-së lidhur me nenin 3 të LPJ-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
CN.nr.350/2021, datë 01.10.2024

Gjyqtari
Uran Zogaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate Themelore.